

U D H Ë Z I M
Nr.20, datë 27.03.2001.

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E KQZ NR.18, DATË 11.03.2001

Nga vrojtimit e bëra në disa ZGJC të Tiranës është konstatuar se ka disa parregullesi nga ana e QIF-it në lidhje me emërtimin e regjistrave. Lidhur me këtë udhëzojmë:

Nëpunësit e ZGJC-ve do të zbatojnë rigorozisht udhëzimin nr.18 dt.11.03.2001 për plotësimin e formularit nr.3, duke mos bërë asnjë veprim jashtë këtyre udhëzimeve. Për të gjitha rekordet, që nuk u përputhet emërtimi i regjistrit të formularit nr.3 të dërguar me atë ekzistues të ZGJC-ve, këto rekorde do të kërkohen në regjistrat e ZGJC-ve me indeksin që kanë këto zyra. Psh: Në formularin nr.3 të dërguar, disa rekorde emërtimin e regjistrit e kanë “KARL GEGA”, në fakt ai i përket regjistrit me emërtim “KONGRESI I PERMETIT”, pra duke hapur regjistrin “KARL GEGA”, këto rekorde nuk gjenden aty, për këtë nëpunësit e ZGJC-ve do t’i kërkojnë me indeks, sepse këto rekorde janë të kësaj ZGJC-ve dhe nuk do të veprohet si në ndonjë ZGJC që këtyre rekordeve u kanë hequr vizë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi